



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1037/1 Prot.

Tiranë, më 05 / 07 / 2019

V E N D I M

Nr. 87 , Datë 05 / 07 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 74, datë 27.06.2019, të F.C kundër Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Pogradec (ZVRPP) dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, Qarku Korçë, (KVVTP) në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “aftësisë së kufizuar¹”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga F.C, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës dhe dokumentet bashkëngjitur, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Me Vendimin nr.3, datë 20.04.2005 është pajisur me aktin e pronësisë, sipas ligjit nr.7501/1991, i ndryshuar, i paplotësuar me tokë që nga viti 01.08.1991. Akti është nxjerrë nga Qarku Korçë në vitin 2005 i shoqëruar me akte dhe vendime të komisionit të tokës të fshatit Leshnicë, në bazë të ligjit nr. 8312/1998. Akti i pronësisë ka dalë mbi bazën e kartelës në zyrën e regjistrimit të pronave dhe hartës topografike të zyrës Pogradec, të cilat vërtetonin që toka ishte shtet dhe duhet të ishte pajisur me certifikatë pronësie në bazë të ligjit nr.7501/1991, i ndryshuar. Pra, prona nga shtet duhet të shënohej në emër të F.C. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me Vendimin nr. (1385)-901, datë 06.12.2010 ka vendosur që prona e F.C ka juridiksion territorial, Komunën Çërravë, Pogradec dhe detyrimin e palëve Komuna Çërravë, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave, të njohin*

¹ F.C është i pajisur me Dëshmi Invalidi të Punës, nr. 808, të lëshuar nga Shoqata e invalidëve të Punës së Shqipërisë, datë 01.10.2018.

këtë fakt, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me Vendimin nr. 218, datë 17.05.2011. Ankuesi pretendon se ZVRPP Pogradec dhe KVVTP Korçë po e diskriminojnë, me sajime, fallsifikime nga më të paligjshmet duke mos i dhënë certifikatën e pronësisë dhe për të qenë pronar i ligjshëm i pronës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kthimin e pronës nga shtet në emër të ankuesit nga ana e ZVRPP Pogradec.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përbashkim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021,

datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Subjekti ankues në formularin e ankesës nr. 74, datë 26.07.2019 ka deklaruar se është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e ZVRPP Pogradec, që nga viti 2006 e në vazhdim. Referuar shkresës nr. 2621/2, datë 04.04.2018 “Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën e F.C (e përsëritur)” të Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në të cilën shkruhet se: “Pranë ZQRPP është administruar kërkesa nr.2621, datë 08.03.2018 e F.C, e përsëritur, me objekt: “Regjistrimin e pasurisë së paluajtshme fituar me AMTP nr.6381/R, datë 18.04.2015 dhe kundërshtimin e veprimeve administrative të ZVRPP Pogradec”. – ZQRPP lidhur me çështjen e F.C nëpërmjet shkresave nr. 1700/3, datë 27.03.2015 dhe nr. 42/1, datë 09.03.2017 “Kthim përgjigje” ka dhënë orientimet ligjore drejtuar ZVRPP Pogradec, janë vënë në dijeni dhe Avokati i Popullit e Ministria e Drejtësisë.

Bazuar në formularin e ankesës, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, F.C është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e ZVRPP Pogradec, që në vitin 2015 e në vijim, sipas shkresës sipërcituar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në lidhje me kërkesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket, regjistrimit të pronës nga shtet në emër të ankuesit nga ana e ZVRPP Pogradec dhe KVVTP Korçë, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. E drejta për regjistrimin e pronës bën pjesë në kompetencën e ZQRPP ose zgjidhet në rrugë gjyqësore.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” citon shprehimisht se: ankesa nuk pranohet nëse: “është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të

kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje”,* ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/dh dhe nenin 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së F.C, për shkak se është jashtë afateve të parashikuara në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

Robert GAJDA

KOMISIONER